



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

### V E N D I M

Nr. 18, datë 29.01.2019

#### MBI

### **NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË DHE NDIHMËS LIGJORË, QË DO TË PRANOHEN PËR TË NDJEKUR PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 29.01.2019, bazuar në nenin 62, pika 14 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenin 53, pika 9 të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

#### **V E N D O S I:**

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.
2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, dy anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jo gjyqtar.
3. Anëtarët e Komisionit të Përkohshëm zgjidhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të bërë nga Kryetari apo çdo anëtar i Këshillit, ndërsa Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit.
4. Komisioni i Përkohshëm verifikon plotësimin e kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, duke i propozuar për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda datës 10 mars 2019, listën përkatëse të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e atyre që nuk plotësojnë kriteret.
5. Për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020,

Komisioni i Përkohshëm, në koordinim dhe bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, administron dhe shqyrton dokumentacionin e depozituar nga çdo kandidat.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrton propozimin e Komisionit të Përkohshëm jo më vonë se data 15 mars 2019.
7. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**